

**Avokati i Popullit
Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve
në institucionin e Avokatit të Popullit**



Në shërbim të interesit më të lartë të fëmijëve, u shërbejmë interesave më të mira të të gjithë shoqërisë

Botimi i këtij materiali mundësohet nga UNICEF dhe është hartuar nga Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve, institucioni i Avokatit të Popullit, nën kujdesin e znj. Erinda Ballanca, Avokat i Popullit, nën drejtimin e Prof. Asoc. Dr. Nejlja Peka, Komisioner për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve dhe me kontributin e:

Dr. Anila Nepravishta – ndihmëskomisioner

Matilda Tyli – ndihmëskomisioner

Donald Fetah – ndihmëskomisioner

Ergyst Jahollari – ekspert

Brisida Kërtusha - ekspert

Tiranë 2021

Botimi i këtij materiali mundësohet nga UNICEF.

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF), është organizata e sistemit të Kombeve të Bashkuara që i përkushtohet plotësisht, kudo në botë, zbatimit të të drejtave të fëmijëve për mbijetesë, zhvillim, mbrojtje dhe pjesëmarrje. UNICEF promovon zhvillimin e qëndrueshëm dhe të drejtë, përfshirjen shoqërore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare për të mbështetur integrimin e Shqipërisë në BE.

UNICEF Shqipëri mbështet reformat e qeverisë, nismat e shoqërisë civile dhe studimet që i ndihmojnë të gjithë fëmijët të gëzojnë të drejtat e tyre njerëzore.

Shqipëria është Shtet Palë i Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe Protokolleve të saj Opsionale. UNICEF ndihmon qeverinë dhe partnerët e zhvillimit që t'i kuptojnë detyrimet që rrjedhin nga ratifikimi i këtyre traktateve dhe t'i përkthejnë ato në legjislacion, politika dhe programe kombëtare. Teksa Shqipëria po synon integrimin në Bashkimin Evropian, UNICEF ndihmon qeverinë që të përqendrohen te fëmijët e grupeve më të cenueshme dhe më të marginalizuara.

Ky botim miqësor publikohet në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së nënshkruar, ndërmjet Avokatit të Popullit dhe UNICEF.

@Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht, që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e organizatave të përmendura më lart si burim.

HYRJE

Të drejtat e njeriut zbatohen për të gjithë pa dallime, fëmijë, të rritur, burra, gra, persona me aftësi të kufizuara, etj. Sidoqoftë, fëmijët janë më të rrezikuar se të rriturit për të mos u respektuar të drejtat e tyre. Ata rriten dhe kapacitetet e tyre evoluojnë gradualisht. Konventa për të Drejtat e Fëmijëve synon të sigurojë, që të drejtat e fëmijëve të respektohen. Fëmijët nuk kanë më shumë të drejta se të rriturit, por ata kanë më shumë mbështetje për t'i ushtruar ato. Për shembull, Konventa përcakton, se ata kanë të drejtë të dëgjohen, se ata nuk kanë të drejtë të diskriminohen në bazë të asaj që thonë ose bëjnë prindërit e tyre, se ata kanë të drejtë të rriten në një familje sa më shumë që të jetë e mundur etj.

Ky botim miqësor përmbledh shkurtimisht përpjekjet e deritanishme, për të finalizuar mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve, në përputhje me konventat dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat që gëzon çdo fëmijë. Mekanizmat përgjegjës, që garantojnë realizimin efektiv të mbikëqyrjes, promovimit dhe mbrojtjes së këtyre të drejtave, janë një fillim i mirë, por që kërkon ende shumë punë për të bërë, shumë përpjekje nga të gjithë ne, shoqëria, të gjithë aktorët dhe faktorët me ndikim në ciklin e politikave publike, ojf, etj.

Nëpërmjet rasteve të mëposhtme ne duam të tregojmë se, fëmijët duhet të kenë qasje dhe akses në mekanizmat, që sigurojnë dhe garantojnë gëzimin e të drejtave të tyre në përputhje me parimet bazë të Konventës dhe, në këtë rast, puna e të gjithëve së bashku, është pikërisht, garantimi i fëmijëve, se një qasje dhe akses i tillë ekziston vërtet.

Çdo fëmijë mund ta gjejë veten në këto situata, dhe shembuj të tillë, të cilët ndahen mes grupesh shoqërore, bëhen dritare ku mund të marrin më shumë informacion për të drejtat që gëzojnë, rrit besimin e tyre kundrejt institucioneve si dhe, u jep mundësinë të marrin vetë në dorë kërkimin e të drejtës, për një të ardhme më të mirë.

Besojmë, se çdo lloj investimi te fëmijët, që promovon potencialin e tyre sot e, që nxit në ta vetëbesimin e nevojshëm, për t'u bërë anëtarë të dobishëm të shoqërisë nesër, qytetarë të përgjegjshëm e me norma, është një investim me vlerë, i cili ka nevojë për përmirësim të vazhdueshëm.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA

DY
FJALË
PËR
INSTITUCIONIN

Çfarë është institucioni i Avokatit të Popullit?

Avokati i Popullit është një institucion i pavarur, i parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i cili nxit standardet më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend. Ky institucion mbron dhe promovon të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të çdo individi, duke përfshirë edhe fëmijët nga veprimet ose mosveprimet e institucioneve publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.



Zonja Erinda Ballanca u zgjodh më 22 maj 2017 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në funksionin e Avokatit të Popullit, për një mandat pesëvjeçar.

Të nderuar lexues të këtij botimi!

Lënda që po ju prezantojmë këtu nuk është asgjë tjetër përveçse distilimi i një pune të gjatë, të kujdesshme e të bërë me zemër!

Kemi sot në duar një përmbledhje ngjarjesh që edhe pse po kujdesemi së bashku me UNICEF që të jenë të përshtatshme për t'u lexuar edhe nga fëmijët, në të vërtetë më shumë na adresohen ne të rriturve.

Shkeljet e të drejtave të fëmijëve në radhë të parë shkaktohen nga jo-fëmijët. Janë institucione të drejtuara prej të rriturish, nëpunës, individë të rritur etj, ata që bëhen shkak që një fëmijë në Shqipëri sot të jetë i ekspozuar ndaj shkeljes së të drejtave të tij apo diskriminimit. Prandaj besojmë se leximi me vëmendje i këtij botimi tej identifikimit të shkelësve, ka qëllim të frymëzojë përmes shembujve konkretë të

punës së bërë në këtë institucion, për të gjetur rrugë kreative në mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Sigurisht, të drejtat mbrohen më mirë nëse ato njihen nga ata që i gëzojnë ato të drejta. Andaj ky botim synon jo thjesht prezantim të rekomandimeve tona adresuar të rriturve, por edhe edukim të fëmijëve përmes shembujve të marrë në këtë tekst. Ai gjithashtu përçon disa mesazhe që mund të jenë jo të gjithpranuara si dhe na tregojnë se jo gjithçka që është e mundur, mund të bëhet.

Avokati i Popullit është një institucion që i mban në zemër fëmijët dhe të drejtat e tyre. Jo më kot, një nga pesë seksionet e këtij institucioni i dedikohet tërësisht mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve.

Përmbledhja e qasjeve të Avokatit të Popullit që synojnë korrigjimin e sjelljes së institucioneve tona në rast shkeljeje të të drejtave të fëmijëve është rezultat i një pune kolektive.

Seksioni i Fëmijëve në Institucionin tonë e ka përgjegjësinë për ndjekjen e përditshme të këtyre rasteve në bashkëpunim me Avokaten e Popullit. Këtë detyrë ky Seksion e kryen në mënyrë shembullore dhe unë gjej rastin sot t'i përgëzoj ata për përkushtimin që manifestojnë në zbatimin e misionit të tyre.

Së bashku me institucionet ndërkombëtare, aktivistët e të drejtave të fëmijëve e në aleancë me vetë fëmijët, Avokati i Popullit në asnjë rast nuk do ta braktisë këtë betejë që ka të bëjë me të ardhmen tonë si qytetarë.

Lexim të mbarë!

Prof.Assc.Dr.Neila PEKA, është zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në 15 mars 2018, për një mandat 4 vjeçar, në funksionin e Komisionerit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve.

Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve drejton dhe përfaqëson Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, në çdo hap të veprimtarisë ligjore dhe administrative të tij.



Ky botim prezanton disa raste të trajtimit të ankesave, me qendër fëmijën dhe të praktikës së mirë të ndjekur nga AP, për trajtimin e ankesave të bëra nga/ose në emër të fëmijëve. Botimi, duke përfshirë parimet e praktikës së mirë të përcaktuara në të, reflekton përvojën tonë institucionale në trajtimin e ankesave, si dhe jemi përpjekur, që nëpërmjet analizës së standardeve përkatëse të të drejtave të fëmijëve, që aplikohen në vendet anëtare të BE-së dhe më gjerë, të promovojmë praktikat e mira në trajtimin e ankesave që prekin fëmijët. Gjithashtu, ky libërth bazohet edhe në studimet ndërkombëtare të ngjashme të institucioneve homologe, që përfshijnë pikëpamjet e fëmijëve dhe të rinjve rreth proceseve të ankesave, që ata kanë përjetuar në një gamë të gjerë sektorësh të veprimtarisë jetësore.

Për të qenë në qendër të fëmijëve dhe problemeve të tyre, është thelbësore të merren parasysh të drejtat e tyre, kur trajtohen ankesat që prekin fëmijët. Për të bërë këtë, duhet jo vetëm t'i kushtosh vëmendjen e duhur interesave më të mira të fëmijëve, por edhe duhen konsideruar e vlerësuar pikëpamjet e tyre përgjatë procesit të ankimit. Mbi të gjitha, një qasje me qendër fëmijët, gjatë shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave të tyre, e mban fokusin të qëndrueshëm tek fëmija (ose fëmijët e prekur nga një ankesë), duke bërë, kështu, që shumë nga ankesat e trajtuara të kenë patur si objekt një numër të caktuar individësh – fëmijë dhe, nga trajtimi i tyre mund të kenë përfituar një numër edhe më i madh ankues/kërkuesish. Kjo do të thotë, se kemi

arritur të trajtojmë e prekim një numër të konsiderueshëm problematikash dhe rastesh, ku fëmijët kanë qenë prezent, madje edhe në thelb të tyre.

Në krahasim me vitet e kaluara, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve **ka një rritje të trajtimit të numrit të ankesave/kërkesave/rasteve me iniciativë me rreth 48%**. Rezultati pozitiv edhe për vitin 2021, konsiston në rritjen e numrit të ankesave të adresuara në institucionin e Avokatit të Popullit **nga vetë fëmijët me rreth 70%**, nga të cilat **pjesa më e madhe kanë marrë zgjidhje pozitive**. Ky numër ankesash nga vetë fëmijët, është motivues nisur edhe nga veprimtaritë promovuese të institucionit, përgjatë viteve të fundit.

Nëpërmjet trajtimit të tyre, në komunikimin administrativ me përfaqësues të pushtetit qendror dhe vendor, kemi synuar jo vetëm zgjidhjen e problematikave të parashtruara mediatikisht, por edhe promovimin dhe nxitjen e një kulture të re, sa i takon zbërthimit korrekt në praktikë të parimit të interesit më të lartë të fëmijëve dhe respektimit të detyrimeve ligjore që burojnë nga ligji nr.18/2017.

Në përfundim, do të theksoja, se risia e këtij botimi miqësor lidhet me faktin, se profesionistët që punojnë drejtpërdrejt me fëmijët janë dhe duhet të jenë të vetëdijshëm, se ekziston një institucion kushtetues i pavarur, si AP është, në të cilin një fëmijë ose i ri mund të shkojë, sa herë që zëri i tij nuk dëgjohet.

Kjo, mund të ketë një efekt parandalues dhe afatgjatë pozitiv në kujdesin ndaj fëmijëve dhe të rinjve!

Çfarë është Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve?

Zyra e Avokatit të Popullit përbëhet nga 5 seksione të specializuara, një ndër të cilët është dhe Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve.

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve është instrument i rëndësishëm në promovimin, monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Seksioni reflekton prioritetet dhe prespektivën e fëmijëve, si dhe mundësitë për të shprehur pikëpamjet e tyre në të gjitha aspektet e veprimtarisë jetësore.

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Fëmijëve përbëhet nga Komisioneri dhe 3 (tre) ndihmëskomisionerë.



Si i mbron seksioni ynë të drejtat e fëmijëve?

Krijimi dhe funksionimi i këtij seksioni në institucionin e Avokatit të Popullit, është tregues domethënës dhe serioz, për garantimin e respektimit të të drejtave të fëmijëve në vendin tonë, pasi kjo zyrë siguron marrjen dhe trajtimin e ankesave, në rastin e shkeljes së këtyre të drejtave, si dhe bë monitorimin në mënyrë të pavarur mbi këto shkelje. Gjithashtu, ndërmjetësimi dhe promovimi i rregullave të reja për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe kryerja inspektive, për të përgatitur raporte monografike dhe për të bërë rekomandime për administratën, me qëllim ndryshimin e praktikave të gabuara administrative ose përmirësimin e legjislacionit është në themel të punës sonë si seksion.

Promovimi i të drejtave të fëmijëve është premisë për realizimin e mbrojtjen e këtyre të drejtave në mënyrë efektive. Sikurse promovimi i të drejtave të fëmijëve, edhe promovimi i rolit të institucioneve, që ushtrojnë veprimtarinë për të garantuar realizimin efektiv të të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre është njëloj i rëndësishëm, po aq sa edhe qëllimet e tjera të evidentuara më lart. Promovimi i të drejtave të fëmijëve në punën tonë, si një detyrim kushtetues, ligjor dhe institucional, nxit garantimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për ta. Përmbyshja e kësaj sfide, nuk mund të realizohet pa bashkëpunimin dhe partneritetin e tyre. Në kuadrin e punës së Seksionit për Mbrojtjen e Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve në institucionin tonë, një nga prioritetet është përfshirja e fëmijëve në çdo vendimmarrje të ciklit të politikave publike, e cila i prek dhe ka rëndësi për ta.



Kush mund të ankohet pranë nesh?

Çdo fëmijë nën moshën 18 vjeç, i cili mendon se të drejtat e tij janë shkelur, mund të bëjë një ankesë pranë Avokatit të Popullit. Në kuptim të parimit të interesit më të lartë të fëmijës, nuk është e nevojshme të merret leje për të paraqitur një ankesë drejtpërdrejt nga fëmija.

Prindërit, të afërmit, kujdestarët ligjorë apo çdo person tjetër, që me ligj kujdeset për fëmijët, kur konstatojnë që nuk respektohen apo shkelen të drejtat e fëmijëve.

Mësuesit, mjekët, punonjësit socialë apo çdo punonjës i institucioneve të trajtimit, edukimit, kujdesit social për fëmijët apo çdo institucioni tjetër, mund të drejtohet

pranë Avokatit të Popullit, nëse konstaton, se gjatë veprimtarisë së tij një institucion shtetëror ka cenuar të drejtat e fëmijëve.

Po kështu, tek AP mund të ankohet çdo punonjës për Mbrojtjen e Fëmijës, gjatë ndjekjes së zbatimit të masës së mbrojtjes dhe Planit Individual të Mbrojtjes, kur vëren se, një prej aktorëve përgjegjës të administratës shtetërore, nuk kryen funksionin e ngarkuar për zbatimin e planit.

Pranë Avokatit të Popullit mund të vijjnë ankesa edhe nga çdo individ, organizatë jofitimprurëse, etj., që ka dijeni për raste të shkeljes apo mosrespektimit të të drejtave të fëmijëve nga organet e administratës shtetërore.

Për çfarë duhet të ankohem?

Avokati i Popullit mbron të gjithë kategorinë e të drejtave të fëmijëve, ashtu siç parashikohet në legjislacionin vendas dhe konventa ndërkombëtare ku ato bëjnë pjesë. Më konkretisht:

- e drejta për jetën;
- e drejta për përkrahje sociale;
- e drejta për arsim, e drejta për kujdes shëndetësor;
- e drejta për t’u mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi, përfshirë edhe shfrytëzimin seksual;
- e drejta për kujdes të veçantë për fëmijët me aftësi ndryshe;
- e drejta për të mos u dënuar, torturuar apo trajtuar në mënyrë mizore;
- e drejta për një proces të rregullt ligjor, akses dhe drejtësi miqësore për të miturit në konflikt me ligjin, viktimat dhe/apo dëshmitarë.
- e drejta për t’u informuar dhe për të marrë pjesë në proceset që prekin të drejtat e fëmijëve.

Nëse mendoni se një organ shtetëror me veprimet ose mosveprimet e tij ka shkelur të drejtat tuaja ju mund të komunikoni me ne dhe të bëni një ankesë.

Ju mund të bëni një ankesë pranë Avokatit të Popullit, edhe nëse mendoni se të drejtat tuaja nuk respektohen, apo parimi i interesit më të lartë të fëmijës nuk është marrë në konsideratë.

Si mund të bëj një ankesë?

Duke u paraqitur personalisht pranë institucionit të Avokatit të Popullit, në adresën: Institucioni i Avokatit të Popullit, bulevardi “Zhan D’Ark”, nr.2.

Ju mund të parqiteni në çdo kohë gjatë orarit zyrtar, nga ora 8.30-16.30, në zyrën e pritjes, ku do të ndihmoheni nga një punonjës i zyrës së pritjes, i cili ju ndihmon të plotësoni formularin e ankesës me shkrim ose, ju jep këshilla juridike apo informacionin të mëtejshëm.

Me postë elektronike, email në adresën: ap@avokatipopullit.gov.al

Me telefon, ju mund të na telefononi ose të na dërgoni sms në numrin:

Tel: 04 2 380 300, 04 2380 333

Fax: 04 2 380 315

Në numrin 08001111 (Për të miturit e ndaluar, të parburgosur dhe dënuar)

Me shërbim postar në adresën **postare: “Zhan D’Ark”, Nr. 2, Tiranë**

Çdo shërbim që bëhet nga Avokati i Popullit lidhur me ankesat, kërkesat apo njoftimet është pa pagesë.

Gjithashtu, mund të shkarkoni edhe Aplikacionin, “Avokati i Popullit”, për t’u ankuar *online*, të cilën mund ta gjeni falas në “Play Store”.

Institucioni i Avokatit të Popullit në përbërjen e tij ka edhe zyrat rajonale në nivel vendor, 7 të tilla:

Zyra Rajonale Berat, Bashkia Berat;

Zyra Rajonale Kukës, Bashkia Kukës;

Zyra Rajonale Fier, Bashkia Fier;

Zyra Rajonale Pogradec; Bashkia Pogradec;

Zyra Rajonale Sarandë, Bashkia Sarandë;

Zyra Rajonale Shkodër, Bashkia Shkodër;

Zyra Rajonale në Minoritet, Njësia Administrative Dropull.

Gjithashtu, në zyrat rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në qytetet e Fierit dhe Korçës, mund të paraqisni ankesën tuaj, në rast të shkeljesë së të drejtave nga ana e organeve shtetërore.

Çfarë duhet të kem parasysh kur bëj një ankesë?

Që ankesa, kërkesa juaj të jetë sa më e qartë dhe e kuptueshme, ju duhet të mbani parasysh:

- për ankesat, kërkesat dhe njoftimet që i dërgohen Avokatit të Popullit, nuk kërkohet ndonjë formë e caktuar, por ato duhet të shprehin sa më qartë arsyen për të cilën bëni ankimin ose kërkesën;
- vendosni të dhënat tuaja, emër mbiemër, adresë ose numrin e telefonit (institucioni ruan të fshehtë identitetin nëse e sheh të arsyeshme, ose nëse kjo kërkohet nga personi që bën ankesën – në këtë rast gjeneralitetet tuaja janë në funksion të komunikimit, ndërmjet institucionit tonë dhe juve si fëmijë);
- përshkruani ngjarjen sa më qartë që të jetë e mundur;
- fokusohuni në çështjet kryesore që lidhen me të drejtat, që ju pretendoni se ju janë shkelur;
- nëse keni dokumente apo prova që lidhen me shkeljen, paraqitini ato;
- përcaktoni institucionin apo personin përgjegjës, me të cilin lidhet shkelja e të drejtave tuaja;
- përcaktoni çfarë zgjidhje kërkoni nga Avokati i Popullit.

Çfarë ndodh pas ankimimit

Pas administrimit ligjor të një ankese/kërkesë, institucioni i Avokatit të Popullit:


- e shqyrton çështjen dhe vëren, nëse ligji i ka dhënë apo jo të drejtë AP-së të trajtojme këtë çështje;
- nëse ka të drejtë AP ta trajtojë çështjen, përpiqet ta zgjidhë sa më shpejt që të jetë e mundur, sipas afateve të përcaktuara në ligjin organik të AP-së, dhe ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”
- mund të komunikojë me ju për të kuptuar më mirë problemin tuaj;
- verifikon, nëse organi shtetëror me veprimtarinë e tij ka shkelur të drejtat tuaja;
- mbledh sa më shumë informacion dhe i kërkon këtij organi shpjegime dhe, nëse e shikon të nevojshme, mund të ndërmarrë edhe një proces hetimi;
- nëse konstaton se veprimet e organit shtetëror kanë cenuar të drejtat tuaja, adreson rekomandime, për marrjen e masave për të vënë në vend të drejtën e shkelur;
- nëse shkeljet janë të rënda, mund të rekomandojë shkarkimin e personave përgjegjës;

- nëse konstaton që shkelja përbën vepër penale, mund t'ia kalojë çështjen organit të prokurorisë dhe t'i kërkojë të fillojë procedim penal.

Në çdo rast, institucioni i AP-së orienton individët dhe çdokënd tjetër që i drejtohet këtij institucioni, për katalogun e të drejtave që gëzon dhe, mënyrën si t'i ushtroni e mbronni këto të drejta.

Përmbajtja skematike e trajtimit të ankesave

TRAJTIMI NË VEPRIM I ANKESAVE ME QENDËR FËMIJËT



E

DREJTA

PËR

ARSIMIM

DËSHIRA PËR TË NDJEKUR

NJË SHKOLLË TË MIRË

Nxënësi X.X. jeton në një zonë rurale, në afërsi të qytetit të Fierit. Pasi ka mbaruar arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar, dëshira e tij ka qenë të ndjekë arsimin parauniversitar, në një nga gjimnazet me emër të qytetit të tij, gjimnazin “Janaq Kilica”. Frekuentimi i rregullt i shkollës ishte i vështirë për të, për shkak të mungesës së transportit në kohë dhe me cilësi.

Mungesa e linjës së autobusëve të shkollës, po vështirësonte jo vetëm arsimimin e tij, por edhe të një grupi shokësh, të cilët çdo ditë përballeshin me të njëjtin problem.

Çdo fëmijë ka të drejtën e frekuentimit të arsimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, kjo e vlefshme dhe për fëmijët që dëshirojnë të arsimohen pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm.

Për të bërë të mundur mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe, në rastin konkret, të drejtën e fëmijës për t’u arsimuar, bazuar në parimin e interesit më të lartë të tij, si dhe garantimin e ushtrimit të kësaj të drejte, në mbështetje të neneve 21 dhe 24, shkronja “a”, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, në institucionin e Avokatit të Popullit, adresoi për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë rekomandimin për ndryshim legjislativ, për rishikimin e vendimit nr.682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimor që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”.



Rekomandimi vuri theksin në përfshirjen e nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm të lartë në përfitimin e transportit falas nga fondet publike, si një e drejtë kushtetuese,

për t'iu garantuar kështu, kësaj kategorie ndjekjen dhe frekuentimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm, pa barriera dhe diskriminim.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, shprehu gatishmërinë për të ndërmarrë veprimet e duhura, duke bërë të mundur që nxënësi X.X dhe shokët e tij, të frekuentojnë shkollën e tyre në mënyrë të rregullt, duke u garantuar atyre të drejtën për arsimim. Propozimi i Avokatit të Popullit do të përfshihet në ndryshimet që priten të miratohen së shpejti me vendim të Këshillit të Ministrave.

DUA DHE UNË TË MËSOJ

Për shkak të situatës së krijuar të pandemisë Covid-19, procesi arsimor në mbarë botën pësoi kufizime që ishin mbyllja e institucioneve të edukimit dhe kalimin e procesit mësimor nga prani fizike në proces *online*. Përgatitja e shpërndarja e udhëzimeve përkatëse për vazhdimin e procesit mësimor *online*, me qëllim garantimin e të drejtës së fëmijës për t'u arsimuar. Kjo situatë penalizoi drejtpërdrejtë edhe nxënësit shqiptarë, të cilët për shkak të vështirësive ekonomike, nuk mund të disponojnë mjetet elektronike të domosdoshme, për të ndjekur mësimin online. Për t'u ardhur në ndihmë këtyre fëmijëve, filantropi Lazim Destani, dhuroi një sasi pajisjesh digjitale (tabletë), për të ndihmuar në procesin e mësimin *online*, në situatën e pandemisë COVID-19. Qëllimi i tij i mirë ka hasur pengesë nga



procedurat doganore, të cilat kanë sjellë bllokimin e mallit në doganë dhe ka penguar nxënësit shqiptarë të kenë në dorë këto pajisje, të cilat janë mënyra e vetme për të ndjekur mësimin.

Jetesa është e vështirë në vendin tonë dhe jo të gjithë prindërit mund t'u përgjigjen kërkesave të fëmijëve për të ecur me hapin e kohës, por vështirësitë ekonomike nuk mund të çënojnë të drejtën e fëmijëve për t'u arsimuar.

Në vlerësim të problematikës së konstatuar, dhe përballja më një situatë të re, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, dhe Avokati i Popullit, trajtuan çështjen në fjalë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Menjëherë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për të garantuar të drejtën e fëmijës në arsim, u angazhua në nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me sponsorizues privatë për dhurimin e pajisjeve elektronike për garantimin e procesit mësimor si dhe pagesën e detyrimeve doganore që rrjedhin në zbatim të saj.

Në sajë të kësaj kontrate dhurimi, ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe kompanisë “Ecolog International”, 500 nxënës që janë në pamundësi financiare, përfituan një pajisje digjitale dhe karta sim me akses në internet, për zhvillimin e mësimin në platformën *online*.

**MBROJTJA
NGA
TË
GJITHA
FORMAT
E
DHUNËS**

POLICIA QË NUK DUAM

X.Y, 15 vjeç, në afërsi të Liqenit Artificial të qytetit të Tiranës, ka vazhduar lëvizjen e tij, përtej fashës orare, të përcaktuar në aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, dhe udhëzimet e ministrit përgjegjës për Shëndetësinë.

Ky veprim i të miturit ka irrituar punonjësin e policisë, inspektor X. X., me detyrë trupë shërbimi-patrullë e përgjithshme në Komisarriatin e Policisë Nr.2, i cili gjatë kryerjes së procedurave të ndalimit dhe shoqërimit forcërisht të shtetasit të mitur me iniciale X.Y., ka përdorur forcë përtej normave të lejuara.

Të rinjtë kanë të drejta të veçanta, por kjo nuk do të thotë që ata duhet të kryejnë veprime të pamenduara dhe në shkelje me ligjin, pasi në një rast apo tjetër ata duhet të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre. Të rinjtë si të gjithë anëtarët e shoqërisë duhet të respektojnë detyrimet e vendosura nga organet shtetërore, në këtë rast kufizimin e lëvizjes. Ata duhet të sillen me edukatë e të ndërveprojnë me punonjësit e Policisë së Shtetit. Gjithashtu, forcat e rendit, kanë mision ruajtjen e sigurisë publike, garantimin e zbatimit të ligjit, por gjithmonë duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

Në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe, në funksion të zbatimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës, për t’i ofruar një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe në mbështetje të pikës 1, të nenit 23, të ligjit nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit, u rekomandoi strukturave përgjegjëse, për marrjen e masave në rastin e dhunës ndaj të miturit X.Y. nga punonjësit e Policisë së Shtetit, si më poshtë:

- bashkërendim më të konsoliduar dhe eficient, ndërmjet strukturave përgjegjëse në nivel vendor për garantimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës;
- trajnime dhe kualifikime të vazhdueshme për punonjësit dhe profesionistët e tjerë, që punojnë në fushat e rendit dhe sigurisë publike, për edukimin mbi/rreth të drejtave të fëmijës;
- hartimi i procedurave standarde operative për punonjësit e Policisë së Shtetit, për qasjen e tyre kundrejt fëmijëve në përputhje me standardet ndërkombëtare të

adresuara për këtë qëllim, si dhe aktet ndërkombëtare e kombëtare në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;

→ kryerja e testeve të gjendjes psiko-sociale dhe emocionale në mënyrë të herëpashershme, të të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit dhe profesionistëve, që punojnë apo janë në kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët;

→ monitorimi në vijimësi i punës së strukturave shtetërore përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi, për vendosjen dhe ekzekutimin e sanksioneve administrative, në rast të mospërbushjes së detyrimeve ligjore nga këto struktura.

Veprimi i punonjësit të policisë, në bazë dhe të rekomandimeve, është dënuar nga autoritetet përgjegjëse, duke e ndëshkuar njëherazi administrativisht me masën e pezullimit nga detyra, si dhe duke i filluar procesi i hetimit disiplinor për shkelje të rëndë. Materialet ndaj tij u referuan në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.



Institucionet përgjegjëse të administratës shtetërore kanë ndërmarrë veprimet e duhura për garantimin e respektimit të jetës dhe mbrojtjes nga cenimi i paligjshëm i dinjitetit të fëmijës.

Mbrojtja nga
përdorimi
i alkoolit,
duhanit
apo
lëndëve narkotike

PIRJA E ALKOLIT NUK TË BËN TË RRITUR

Ky është rasti i dy shokëve, të cilët ishin shumë kuriozë dhe donin të provonin ndjesinë e të qenit të rritur. Pasi kishin abuzuar me substanca alkoolike, aventura e tyre nuk përfundoi mirë, dy të miturit e gjetën veten në gjendje të rënduar në spital, por fatmirësisht jashtë rrezikut për jetën.

Në vendin tonë, sipas legjislacionit në fuqi, ndalohet shitja ose ofrimi falas i pijeve alkoolike të miturve, apo konsumimi i tyre në vende publike. Gjithashtu, në shkollë është e ndaluar konsumimi i pijeve alkoolike apo drogërave të ndryshme.

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes, pasi konstatoi shkeljen e të drejtës së fëmijës, mbrojtja e veçantë e fëmijës nga substancat alkoolike.

Njësia për Mbrojtjen e fëmijës, struktura përgjegjëse vendore, e cila funksionon pranë çdo bashkie, është hallka e parë që identifikon raste të tilla, në bashkëpunim me struktura të tjera si Shërbimi Spitalor, zyra arsimore vendore dhe shkolla.

Pasi janë identifikuar dy të rinjtë, janë ndjekur disa hapa, të cilat do të jenë ndihmëse në parandalimin e rasteve të tjera në të ardhmen.

Të miturit janë intervistuar në prani të familjarëve, me qëllim informimin me të drejtat dhe detyrimet e tyre për rastin në fjalë. Më pas, janë vlerësuar nevojat e të miturve nga informacionet e ndërmarra nga intervista dhe burime të tjera të strukturave përgjegjëse në nivel vendor.



Janë realizuar takime të grupeve multidisiplinare në mjediset e shkollës së të miturve, me pjesëmarrjen e aktorëve përgjegjës të strukturave shtetërore, si drejtuesi i shkollës, prindërit, mësuesit kujdestar të klasave respektive të të miturve, punonjësit e shërbimeve psiko-sociale të shkollës, si dhe përfaqësuesi i seksionit të Policimit në Komunitet.

Në përfundim, është hartuar plani i mbrojtjes individuale për çdo të mitur me masat përkatëse.

Situata të tilla nxjerrin në dukje mangësitë që kanë strukturat përgjegjëse vendore në lidhje me burimet njerëzore që ofrojnë shërbimet psikosociale në shkolla, trajnimin dhe ngritjen e tyre profesionale. Burimet njerëzore që ofrojnë këto shërbime duhet të shtohen dhe fuqizohen, por mbi të gjitha duhet të ndërgjegjësohen për përgjegjësinë që kanë lidhur me identifikimin dhe raportimin e fëmijëve në risk.

**E
DREJTA
E FËMIJËS
PËR
NIVEL JETESE
TË
PËRSHTATSHËM**

DUA NJË FAMILJE TË BUKUR

X.K, vajza e mitur 4 vjeçare e familjes D.K nuk e ka frekuentuar asnjëherë kopshtin. Ajo po rritet në një shtëpi me qira, nga prindër të papunë dhe me një gjendje të vështirë ekonomike. Njëri prej prindërve është i paaftë për punë, por Komisioni Shumëdisiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar ka refuzuar kërkesën e tij, pasi diagnoza e tij nuk është përfshirë në udhëzuesin mbi vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar tek fëmijët/të rriturit.

Familje me prindër të sëmurë, që jetojnë në kushte të vështira, ku mungon ushqimi i shëndetshëm, kujdesi shëndetësor, nuk janë një ambient fort i përshtatshëm për mirërritjen e një fëmije. Prindërit janë përgjegjës dhe duhet të mbështesin fëmijët deri në momentin që ata do t'i dalin zot vetes. Në rast se prindërit nuk ia dalin është shteti me strukturat përgjegjëse, që duhet të ndërhyjë në ndihmë të tyre.

Në mbrojtje të interesit më të lartë të fëmijëve, AP/SMPDF trajtoi problematikën e situatës së vështirë ekonomike të familjes së D.K. duke vënë në dijeni qytetarin dhe sugjeruar ndjekjen e udhëzimeve për një zgjidhje të shpejtë administrative.

Drejtorja e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale pranë bashkisë, ka orientuar prindin, që të paraqitet në zyrën e punës, në mënyrë që të kryejë regjistrimin si punëkërkuës dhe më pas, të aplikojë në zyrën e ndihmës ekonomike. Gjithashtu, i është sugjeruar që të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm në zyrën e strehimit, për përfitimin e bonusit të qerasë. Përsa i përket të miturës, punonjësja e NJMF ka kryer procedurat përkatëse për regjistrimin e saj në kopsht.



**MBROJTJA
E
FËMIJËS
VIKTIMË
E
DHUNËS**

NUK DUHET TË FLASËSH ME TË PANJOHUR

X.X, e mitur, vetëm 10 vjeç, është abuzuar seksualisht nga një i panjohur. Nëna e të miturës, e cila, pasi ka vënë re gjendjen e rënduar psikologjike të vajzës, dhe ka mësuar situatën në të cilën ndodhet ajo, ka bërë kallëzim ndaj shtetasit të dyshuar për abuzim.

Legjislacioni në fuqi përcakton se, fëmijët kanë të drejtë të mbrohen nga të gjitha format e dhunës, duke përfshirë edhe abuzimin seksual. Janë prindërit e fëmijës dhe institucionet e kujdesit shëndetësor dhe shoqëror, të cilët duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të bërë të mundur rehabilitimin fizik, psikologjik si dhe integrimin social të fëmijës.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në mbrojtje të interesit më të lartë të fëmijës, ka trajtuar problematikën e familjes X, duke përfshirë prindërit, vajzën e abuzur si dhe motrën e saj, e cila është gjithashtu e mitur.

Pas vlerësimit psikologjik, rezultoi se dy të miturat ishin në gjendje të rënduar. Gjatë kësaj kohe u monitorua edhe situata e prindërve, për të cilët u vendos të



akomodoheshin, për një periudhë të pacaktuar në një nga banesat që disponon Drejtoria e Shërbimit Social. Pas vendimit të marrë nga gjykata e rrethit, vajzat e mitura janë vendosur në përkujdesje alternative pranë një qendre rinore dhe u ofrohet shërbim psikologjik dhe të gjitha kushtet e nevojshme për jetesë dhe arsimim. Po ashtu, edhe prindërit janë në mbikqyrje për të siguruar ecurinë e sjelljes së tyre, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe kushteve social-ekonomike të jetesës për mirëqënien e vajzave të mitura.

Duhet të jenë vetë të rinjtë, të cilët duhet të ndërgjegjësohen mbi problematikën e abuzimit seksual dhe të mësohen me kulturën e ngritjes së zërit dhe raportimit të rasteve të abuzimit, që situata të tilla të mos përsëriten më. Ata duhet të kuptojnë se nuk janë vetëm në luftën kundër abuzuesve, përkundrazi ata nuk duhet të stigmatizohen nga shoqëria, pasi lufta kundër çdo forme dhune ndaj fëmijëve është përgjegjësi kolektive e të gjithë shoqërisë.

NËNA

TË JEP JETËN, POR MËMËSLA ËSHTË PËRGJEGJËSI!

Mediat *online* janë kthyer në një burim informacioni në dorën tonë, por në shumicën prej tyre mbizotërojnë lajme të zymta. Prej ditësh qarkullonte online një lajm pak i pazakontë për shoqërinë tonë: “Nëna rreh në mënyrë makabre vajzën 3 vjeçare”. E mitura R.A, jeton me dy prindërit e saj në një qytet të vendit tonë.

Sipas legjislacionit në fuqi, çdo lloj forme dhune ndaj fëmijës, është e ndaluar. Këtu përfshihet çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike, mendore, lëndim, keqtrajtim, lënie pas dore etj.

Stresi, sëmundjet mendore, marrëdhëniet jo të mira mes bashkëshortëve, sjellin një mjedis jo të përshtatshëm për rritjen e fëmijëve. Në të tilla raste, dhuna bën që jetesa në këto familje të bëhet e vështirë, fëmijët të mos rriten nga prindërit, por të jenë pjesë e programeve të ndryshme sociale, kjo për të mirën e tyre dhe të ardhmes së tyre.


SMPDF ka ndjekur rastin si dhe menaxhimin nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës pranë bashkisë përkatëse.

E mitura menjëherë ka marrë Urdhër Mbrojtjeje, është larguar nga banesa dhe është vendosur në një ambient të sigurt, në përkujdesje alternative pranë Qendrës së Emergjencës, për një afat 20 ditor.

Ndërkohë është hartuar dhe një Plan Individual për Mbrojtjen e Fëmijës, pjesë e të cilit është edhe aftësimi prindëror.

Pas mbarimit të periudhës 20 ditore, fëmija është vendosur në kujdestarinë alternative të të afërmeve, përkatësisht gjyshërve të saj. Prindërit janë përfshirë në programe specifike prindërimi. Nëna e fëmijës gjatë shërbimit të provës, do të marrë mbështetjen e duhur psikologjike për t’u riaftësuar.

Familjet shqiptare duhet të ndërgjegjësohen, që dhuna ndaj fëmijëve është e ndaluar me ligj dhe nuk duhet të ecin me parimin “je fëmija im, unë të kam bërë, unë nuk po thyej ligjin”. Familja duhet të jetë streha e sigurt ku fëmijët rriten me dashuri.



E
DREJTA
PËR KUJDES
NDAJ
FËMIJËS
ME
AFTËSI
NDRYSHE

JAM NJË PREJ JUSH

Vajza 7 vjeçe, vuan me çrregullime të spektrit të autizmit. Ajo jeton në një shtëpi më qira, së bashku me nënën dhe motrën e saj. Shpesh ajo bëhet agresive dhe dëmton veten. Nëna e të miturës, e gjendur në kushtet e papunësisë, të mungesës së strehimit, të zgjidhjes së martesës, të dhunës së pretenduar nga ish bashkëshorti dhe, kur nuk mund të përballojë mirërritjen, zhvillimin dhe mbështetjen me trajtim terapeutik ndaj saj, ka kërkuar ndihmën e shtetit, për të përshpejtuar akomodimin e vajzës së saj në një qendër të përkujdesit rezidencial.

Fëmija me aftësi ndryshe gëzon të drejtën për të përfitur nga shërbimet shëndetësore, sociale, edukative, sipas nevojave, të përcaktuara përgjegjëse të vlerësimit të Autoritetet përgjegjëse shërbime të ofrohen sa më falas, sa herë të jetë e mundur parasysh gjendjen ekonomike të Prindi ose kujdestari ka detyrimin të ndjekë procedurat e detyrueshme, sipas këtij ligji, për t'i siguruar fëmijës aksesin në të gjitha shërbimet, nga të cilat përfiton, sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, prindi ose kujdestari asistohet nga strukturat e mbrojtjes së fëmijëve, sipas nevojës.



Rasti konkret është mjaft kompleks dhe emergjent për ndihmë. Ai ka të bëjë me mbijetesën dhe problematikat e një nëne të re, e cila pasi ka zgjidhur martesën, vuan varfërinë dhe mungesën e një strehe edhe për dy fëmijët e saj të mitur.

Detyrimin ligjor për fuqizimin e familjeve në kushtet e vështira social-ekonomike, e ka pushteti vendor. Me qëllim mbrojtjen e fëmijës, është i domosdoshëm ofrimi i shërbimeve, sipas nevojave, si dhe realizimin e ndërhyrjeve për respektimin e të drejtave të fëmijës, të cilat synojnë zhvillimin dhe mirëqenien e të miturit në mjedisin e tij familjar. Rekomandimet e Avokatit të Popullit për vlerësimin me prioritet e shpejtësi të nevojave të fëmijës, hartimin e planit të mbrojtjes për të siguruar mbijetesën dhe mirëqenien e tij, duke konsideruar ofrimin e shërbimit të kujdesit shoqëror në një qendër zhvillimi, në interesin më të lartë të fëmijës, deri në fuqizimin social, psikologjik e ekonomik të familjes, janë pranuar dhe e mitura po merr shërbimin e duhur.

**E
DREJTA
E
FËMIJËS
PËR TË
TUBUAR
DHE
ORGANIZUAR**

DUA EDHE UNE TE PROTESTOJ

Fëmijës i garantohet liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore

Ndalohet detyrimi i fëmijës për tubim në kundërshtim me vullnetin e tij.

Mediat *online* janë burim informacioni për institucionin e Avokatit të Popullit, për identifikimin e çështjeve të ndryshme lidhur me shkeljen e të drejtave të fëmijës. Pikërisht, në mediat sociale u transmetuan dy video, të realizuara në mjediset e shkollës së mesme të përgjithshme “S. F.”, ndërmjet nxënësve dhe drejtuesit të këtij institucioni, me inicialet T.D., me temë protestën e studentëve zhvilluar në muajin dhjetor 2018.

Në videon e parë, të publikuar në media, shfaqej drejtuesi i shkollës së mesme të përgjithshme “S. F.”, që u kërkonte me forcë nxënësve të shkollës për të mos marrë pjesë në protestën e studentëve. Ndërsa në videon e dytë, të publikuar drejtuesi i shkollës së mesme të përgjithshme “S. F.” ka mbledhur sërish nxënësit e kësaj shkolle, për të gjetur “fajtorin”, i cili/e cila ka realizuar regjistrimin dhe publikimin e mbledhjes së organizuar.

Për këtë qëllim, Avokati i Popullit filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes, me nismën e vet, për këtë rast të bërë publik duke ndërmarrë një hetim të pavarur administrativ në mjediset e shkollës së mesme të përgjithshme “S. F.”, për një shqyrtim dhe gjykim korrekt dhe objektiv rreth ngjarjes së ndodhur në shkollën e mesme të përgjithshme “S. F.”.

Në takimin e organizuar në mjediset e shkollës punonjësit e institucionit të Avokatit të Popullit, zhvilluan biseda paraprake me drejtuesin e shkollës së mesme të përgjithshme “S. F.” dhe kërkuan dokumente të ndryshme të tilla si: rregullorja, aktet e nënshkrimit, ndërmjet prindërve dhe mësueseve, për mënyrën e përdorimit të celularëve në shkollë, etj. (të cilat i janë vënë në dispozicion punonjësve të institucionit të Avokatit të Popullit).

Gjithashtu, u zhvilluan intervista me nxënësit (nxënësit ishin përfaqësues së qeverisë së nxënësve, senatorët e klasave të zgjedhur në përputhje me legjislacionin e brendshëm për arsimin parauniversitar), pjesëmarrës në takimin e realizuar nga drejtuesi i institucionit me autorizim dhe lejen e prindërve apo kujdestareve ligjor. Të gjitha këto veprime të realizuara, ndihmuan punonjësit e Avokatit të Popullit në vlerësimin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, që përcaktojnë të

drejtat e fëmijëve, mekanizmat dhe autoritetet shtetërorë përgjegjës, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin dhe promovimin e këtyre të drejtave dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijëve.

Nisur nga analiza e fakteve, rrethanave dhe deklarimeve, të mbledhura gjatë hetimit administrativ të kryer, në mjediset e shkollës së mesme të përgjithshme “S. F.”, Avokati i Popullit konstatoi, se stafet pedagogjike në shkolla kanë mangësi në drejtim të komunikimit me nxënësit në aspektin e njohjes dhe ushtrimit të të drejtave nga ana e nxënësve. Pikërisht, kjo mungesë komunikimi ka pasqyruar **shkeljen e të drejtave të fëmijëve për t’u dëgjuar e për t’u organizuar**, në interesin më të lartë të tyre¹. Kështu, mosvlerësimi i aftësive dhe zërit të fëmijëve, si dhe ushtrimi i kompetencave dhe detyrave funksionale nga ana e stafit drejtues të shkollës është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Marrëdhënia mësues-nxënës duhet të karakterizohet nga integriteti, besimi i ndërsjellë dhe bashkëpunimi, duhet të jetë një marrëdhënie e shëndetshme dhe, që synon gjithmonë të ndërtohet mbi baza të vërteta (edhe nëse, gjatë ndërtimit të saj gabohet). Të kërkuar nëpërmjet sjelljeve intimiduese, që fëmijët të mos jenë të vërtetë në veprimet, gjykimet dhe qëndrimet e tyre, është tërësisht në kundërshtim edhe me normat e moralit shoqëror.

Gjatë ushtrimit të funksionit mësuesit dhe drejtuesit e institucioneve të arsimit udhëhiqen nga parimi kryesor, interesi i nxënësit është parësor. Pra, drejtuesi i institucionit arsimor duhet t’u krijojë kushte dhe mundësi nxënësve, që të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera, që kërkon sot një shoqëri demokratike dhe, për t’i zhvilluar ato në mënyrë të pavarur e të gjithanshme. Thënë kjo, në drejtim të përgatitjes për të kontribuar jo vetëm në ndërtimin e mirëqenies vetjake, por dhe të formimit të një individi me vlera në shoqëri, për t’u përballur nesër në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Mospërbushja e këtij funksioni, rrjedhimisht sjell edukimin e tyre me modelin e gabuar.

Nisur nga evidentimi i problematikave të lartpërmendura, me qëllim vënien në vend të së drejtës së fëmijës për t’u dëgjuar dhe për t’u organizuar (e drejta për tubim), Avokati i Popullit adresoi rekomandimet për:

¹ Një shembull i garantimit të së drejtës për t’u dëgjuar dhe për të qenë pjesëmarrës në nivelet më të larta të vendimmarrjes, është rasti i adoleshentes së re nga Suedia, Greta Thunberg. Si aktiviste e çështjeve mjedisore, kauza e saj mori jehonë ndërkombëtare, pikërisht për ndryshimet klimatike dhe ndikimi i tyre në jetën tonë.

Së pari, për forcimin e punës, për përsosjen e marrëdhënieve edukatorë-fëmijë, mësues-nxënës, marrëdhënie bashkëpunimi për një edukim cilësor, bashkëkohor, marrëdhënie bashkëpunëtorësh. Kjo për të siguruar një shtrat të shëndetshëm për funksionimin e metodave aktive krijuese në edukim e arsimim, marrëdhënie të shëndetshme, që nuk i lënë shteg shfaqjes dhe veprimit të autoritarizmit në edukim si dukuri karakteristike e shoqërive jodemokratike. Marrëdhëniet e singerta, ndërmjet nxënësve dhe mësuesve synojnë përmirësim e jo penalizim, ndikojnë fuqishëm në formimin e autoritetit të vërtetë të edukatorit dhe nxënësit, në konsolidimin e respektit real të ndërsjellë.

Së dyti, marrjen e masave nga institucionet edukative e më gjerë, për të punuar më shumë me fëmijët, në drejtim të edukimit, ndërgjegjësimit, dhe informimit të tyre, lidhur me të drejtën e tubimit dhe organizimit dhe, të promovojnë praktika të mira pune për përmbushjen e kësaj të drejte.

Veprimet e drejtueses së shkollës së mesme të përgjithshme, që çuan në cenimin e të drejtë së fëmijës për t'u organizuar, nisur nga rekomandimet e adresuara nga Avokati i Popullit, janë vlerësuar nga autoritetet përgjegjëse të institucioneve të edukimit, duke realizuar transferimin e saj në një institucion tjetër arsimor.

Institucionet arsimore dhe çdo institucion tjetër publik apo privat mbikëqyrin, nëse kjo e drejtë garantohej nga institucionet përgjegjëse dhe, në rast mosrespektimi, njoftojnë organet e policisë për marrjen e masave konkrete, sipas legjislacionit në fuqi, duke mbajtur në vëmendje sigurinë e fëmijës gjatë ushtrimit të kësaj të drejte.



DY FJALË

PËR TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN,

VIKTIMA DHE/APO DËSHMITARË



ËSHTË E LEHTË TË NDËRTOSH NJË FËMIJË TË FORTË, SE SA TË NDREQËSH NJË NJERI TË THYER

Gjatë ushtrimit të funksionit kushtetues, ka rezultuar se fëmijëve në konflikt me ligjin iu shkelet më shumë se një e drejtë dhe në mënyrë të përsëritur. Edhe pse flasim për rehabilitim të këtyre fëmijëve të stigmatizuar nga shoqëria, jemi shumë larg përmbushjes së standardeve minimale të trajtimit të tyre. Kjo, si rrjedhojë e mungesës së bashkëpunimit, koordinimit dhe bashkërendimit institucional, profesionistët në sistemin e drejtësisë, në shërbimet sociale, ata që kujdesen për shërbimet e akomodimit dhe shërbimet e shëndetësisë. Të gjitha këto struktura duhet të punojnë bashkë dhe të përpiqen të gjejnë zgjidhje të përbashkëta për të miturit në konflikt me ligjin.

Ajo që kërkohet në mënyrë të vijueshme nga AP, në të gjitha rekomandimet e tij, jo vetëm në kuadër të zbatimit të legjislacionit të administrimit të drejtësisë penale për të mitur, është, se shteti duhet të dedikojë buxhete të mjaftueshme e të veçanta, për të garantuar funksionimin e sistemit ligjor miqësor për mbrojtjen dhe integrimin e fëmijës, si dhe dënimi me burgim, duhet të përdoret si masë e fundit për të miturit në konflikt me ligjin dhe për periudhën më të shkurtër kohore. Për të bërë të mundur këtë duhet të funksionojnë programet e rehabilitimit e riintegrimin, duke i bërë pjesë të punës së përditshme të profesionistëve, që punojnë me këta fëmijë, me qëllim krijimin e konsolidimin e një sistemi që i rrit dhe i zhvillon si qytetarë të përgjegjshëm e me norma.






Intervista e kryer me të miturin në konflikt me ligjin, viktimë dhe /apo dëshmitar bëhet në një mjedis miqësor, duke krijuar kushtet e përshtatshme në përputhje me gjininë, gjendjen shëndetësore dhe psikologjike të tij, si dhe në çdo rast në prani të mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor dhe psikologut.

Për garantimin dhe sigurimin e të drejtave të të miturve në çdo fazë të procedimit penal, veçanërisht e drejta për ndihmë ligjore dhe psikologjike, sipas përcaktimeve në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, është një detyrim ligjor.

Për komunikimin e të drejtave të të miturve të ndaluar/shoqëruar dhe të arrestuar, nënshkrimi i kopjeve të deklaratës për njohjen e të drejtave që ato gëzojnë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, është një detyrim ligjor.

Në përfundim, mendojmë se çështja kryesore, që fëmijët përfundojnë në sistemin tonë të drejtësisë për të mitur, është sepse ne si shoqëri nuk kemi qenë në gjendje të përmbushim nevojat e tyre në komunitetet prej të cilave ata vijnë!



JO GJITHÇKA QË ËSHTË E MUNDUR

MUND

TË BËHET

Nuk është puna jonë që t'i kalisim fëmijët tanë për t'u përballur me një botë mizore dhe të pashpirt. Është puna jonë për të rritur fëmijë, që do t'a bëjnë botën pak më pak të egër dhe të pashpirt

Çdo fëmijë ka të drejtën e jetës për një zhvillim fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror . Të gjitha këto të drejta dhe nevoja thelbësore ekzistojnë te çdo fëmijë, pa dallim race, kulture, besimi fetar, gjinie, klase apo moshe. Të drejtat tek fëmijët janë në varësi të tyre, pasi çdo fëmijë është unik dhe ai ka nevoja të veçanta në përputhje me karakteristikat e moshës dhe të stadi të zhvillimit dhe këto nevoja ndryshojnë me rritjen e fëmijës.

Fëmijët kanë nevojë për mbrojtjen e veçantë nga shteti, ndaj Kushtetuta e RSH-së, si ligji themeltar i shtetit e ka parashikuar një mbrojtje të tillë. E përveç të drejtës për mbrojtjen e veçantë nga shteti, Kushtetuta ka parashikuar që fëmijët kanë të drejtën të jenë të mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.

Shteti, brenda kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore, mjeteve që disponon, synon t'u garantojë fëmijëve arsimim dhe kualifikim sipas aftësive të tyre, një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm. Zbatimi objektivave socialë, që Kushtetuta jonë parashikon, duhet të rregullohet me ligje të posaçme, të cilat përcaktojnë kushtet dhe masën, deri ku mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave.

Pavarësisht, kushteve ligjore, ekonomike dhe sociale të shtetit, të drejtat dhe liritë themelore të individit, qoftë ky edhe fëmijë, qëndrojnë në themel të të gjithë veprimtarisë jetësore të një shteti dhe, është detyrë parësore e organeve të administratës shtetërore të përpiqen në realizimin dhe garantimin e ushtrimit të këtyre të drejtave, në interesin më të lartë të fëmijës.

Përtej punës së përditshme me të rriturit dhe fëmijët, luftës për të çuar përpara kauzat e tyre në dukje të vogla e vetjake e, përmes tyre, kauzën e madhe të ndërtimit të një

shoqërie më të drejtë, ka gjithsesi vend për reflektim. Reflektim nga ne të gjithë, për të kuptuar që jo çdo e drejtë mund të ushtrohet në mënyrë të pakufizuar.

Thënë kjo, të gjithë duhet të kuptojmë dhe ndërgjegjësohemi, që aty ku ka të drejta, ka edhe detyrime, detyrim për të respektuar ligjin, rregullat, lirinë, etikën dhe integritetin e individit, vlerat e moralit shoqëror.

Katalogu i të drejtave

Të gjithë fëmijët nën moshën 18 vjeç gëzojnë të drejta, të cilat u mundësojnë atyre të trajtohen në mënyrën e duhur dhe të kenë të gjithë kujdesin e nevojshëm për një rritje dhe zhvillim sa më të mirë. Të drejtat e fëmijëve garantohen përmes ligjeve të shtetit dhe akteve ligjorë ndërkombëtare të njohur nga vendi ynë.

Akti më i rëndësishëm NDËRKOMBËTAR ku janë sanksionuar të drejtat e fëmijëve është Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, e cila është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në 20 nëntor 1989, dhe është ratifikuar nga vendi ynë me ligjin Nr. 7531, datë 11.12.1991.

Konventa parashikon të drejtat bazë të fëmijëve, si dhe detyrimin që kanë shtetet për mbrojtjen, respektimin dhe promovimin e të drejtave të tyre. Ajo shërben si pike referimi për katalogun e të drejtave të fëmijëve, duke qenë se kjo Konventë është pranuar nga pothuajse të gjitha vendet e botës (191 vende).

Disa prej të drejtave Disa prej të drejtave kryesore

- *Mbrojtja e jetës dhe mirëqenies fizike, mendore, shpirtërore, morale dhe sociale.*
- *Respekti për nevojat tuaja themelore: të jeni ushqyer siç duhet, të veshur, të keni një banesë dhe të kujdeseni për veten.*
- *Një identitet :një emër, një mbiemër dhe një kombësi.*
- *Të trajtoheni si fëmijët e tjerë pavarësisht nëse jeni mashkull, femër pavarësisht origjinës tuaj, mendimeve tuaja, besimit tuaj apo besimit të prindërve tuaj.*
- *Të kesh prindërit dhe të jetosh në familje. Kur kjo gjë nuk është gjithmonë e mundur, ju keni të drejtë për zgjidhjen e situatës së përshtatshme për ju.*
- *Arsimimin më të mirë të mundshëm.*
- *Mbrojtja kundër të gjitha formave të shfrytëzimit, abuzimit seksual dhe dhunës fizike ose mendore. Askush nuk ka të drejtë t'i nënshtrojë fëmijët në të tilla abuzime.*
- *Pushimi, lojrat, aktivitetet kulturore dhe artistike të përshtatshme për moshën.*
- *Kushtet e veçanta që sigurojnë dinjitetin dhe autonominë tuaj kur jeni i sëmurë, ose nëqoftëse keni një aftësi të kufizuar fizike apo mendore.*
- *Mbrojtja e jetës tuaj private duke përfshirë këtu edhe rrjetet sociale, askush nuk ka të drejtë t'iu ngacmojë apo të flasë në vendin tuaj.*
- *Të shprehni, të merni pjesë në vendimet që ndikojnë te ju apo në jetën tuaj sociale. Kjo e drejtë rritet me moshën tuaj.*
- *Një drejtësi e përshtatur për fëmijët.*

EDUKIM

MBROJTJA E TË RINJVE



PUNA

MIRËQËNIE

TË RINJTË DHE TË DREJTAT E TYRE